



## P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **30.06.2025**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**. Në fillim kryesuesi konstatoi se kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 31 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 24.

**Kryesuesi:** Përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, **z. Smajl Latifi**, Nënkyetar **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtore të drejtorive komunale, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit. Për këtë mbledhje të **gjashtë** me radhë të vitit 2025, së bashku me kryetarin, kemi vendosur për këtë rend dite:

### REND DITE

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;**
- 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), 2026-2028;**
- 4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për konstituimin e të drejtës së kalimit (servitutit sendor), ZK-Rahovec;**
- 5. Shqyrtimi dhe mratimi i vendimit për miratimin e Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijëve 2025-2028;**
- 6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 nr.47/25, i datës 29.4.2025, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV);**
- 7. Shqyrtimi i raportit 6-mujor, janar-qershori 2025 të kryetarit të komunës;**
- 8. Shqyrtimi i Informatës rreth aktivitetave të KKSB-së për 6 mujorin e parë të vitit 2025;**
- 9. Shqyrtimi i raportit rreth aktivitetave të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, për 6-mujorin e parë të vitit 2025;**
- 10. Shqyrtimi i informatës për gjendjen e mbeturinave në komunën e Rahovecit, për 6-mujorin e parë të vitit 2025.**

**Shtesë: Vendim për emërtimin e Qendrës për Kulturë, Arte dhe Inovacion “Avdullah Bugari”.**

**Kryesuesi:** Të nderuar anëtarë të kuvendit, në emailet tuaja ka ardhur edhe një pikë shtesë: Vendim për emërtimin e Qendrës për Kulturë, Arte dhe Inovacion “Avdullah Bugari” dhe për arsyetimin e kësaj pike e ftoj kryetarin.

**Kryetari:** I nderuar kryesues, drejtore të drejtorive, nënkyetar, anëtarë të kuvendit, përfaqësues të LMT-së, KFOR-it dhe të nderuar qytetarë. Kjo pikë ka ardhur pak me vonesë, është kërkeshë e protokoluar nga Organizata e Veteranëve të Luftës – dega në Rahovec dhe besoj që është mjaftë e rëndësishme që një objekt i rëndësishëm inovativ, kulturor dhe multifunksional ta ketë emrin e bashkëluftëtarit tonë, Avdullah Bugari, i cili ka rënë më 17 korrik 1998. Avdullah Bugari është dëshmori i parë i Epopesë së Korrikut të UÇK-së në Rahoveci. Me ndër dhe respekt ju ftoj që të futet në rend dite kjo pikë. Në fakt, ai ka qenë edhe artist, humorist dhe pjesëmarrës në aktivitete

kulturore, përveç atyre luftarake. Besoj që ky emër e nderon këtë objekt të rëndësishëm të kulturës, rinisë, artit dhe inovacionit.

**Defrim Kafexhiu:** Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkyetar, kolegë anëtarë të kuvendit, drejtorë të drejtorive dhe të gjithë ju të pranishëm. Kur t'i vie radha kësaj pike, e kemi një fjalë rasti për këtë vendim të rëndësishëm që ka ardhur sot në kuvend dhe si anëtarë të kuvendit e kemi fatin ta votojmë një pikë të tillë. Një pyetje, në vendim po shkruan: Emërtimi i Qendrës për Kulturë, Arte dhe Inovacion “Avdullah Zijajdin Bugari”, apo është vetëm formalisht kështu?

**Kryesuesi:** Faleminderit, Defrim Kafexhiu! Nëse jeni të pajtimit, pikën shtesë e vendosim në votim. Kush është “për”... Unanimisht (24) votohet pika shtesë. Tani e vendosim në votim tërë rendin e ditës. Kush është “për”... Kundër... Abstenim?... Me shumicë votash (20) votohet rendi i ditës për mbledhjen e sotme. Të nderuar anëtarë, me mirëkuptimin tuaj ju kërkoj që pika e tretë të kalojë në renditje si e dyta dhe e dyta si e treta, me arsyetimin e drejtorit për buxhet dhe financa.

**Afrim Limani:** I nderuar kryesues, kryetar, nënkyetar, asambleistë. Arsyetimi pse kjo kalon në vendin e dytë është, sepse sot është data 30 qershor dhe sot duhet ta dorëzojmë këtë dokument. Nëse pajtoheni ju, atëherë këtë pikë e vendosim si pikë numër 2.

**Kryesuesi:** Atëherë, kush është “për”... Konstatoj që, unanimisht pika e tretë kalon si pikë e dytë.

### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**

**Kryesuesi:** A kemi ndonjë gjë rrëth procesverbalit nga maledha e kaluar?... Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”... Konstatoj që unanimisht (20) votohet pika e pare e rendit të ditës.

### **2. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), 2026-2028:**

**Afrim Limani:** Faleminderit kryesues! Të nderuar asambleistë, qarkorja e parë buxhetore ka ardhur më 16 maj 2025 dhe nga kjo datë e kemi analizuar, i kemi pa kufijtë buxhetor dhe mbi bazën e kësaj e kemi përgatitur KAB-in komunal. Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2026 është 21.547.000€ dhe nëse e krahasojmë me periudhën e vitit 2025, atëherë kemi një rritje prej 564.936€. Kjo gjendje për neve është risi dhe konsideroj që këtu janë tre elemente që e veçojnë këtë qarkore dhe e emëruesh e përbashkët e kanë zvogëlimin e numrit të popullsisë. E thash që tri veçuritë kryesore janë në buxhetin e arsimit, administratës dhe të shëndetësisë. Buxheti i administratës është i njëjtë me vitin e kaluar, mirëpo qeveria e ka buxhetuar në vlerë prej 677.000€. Viteve të tjera nuk do të përsëritet, sepse do të llogaritet me formulën në bazë të numrit të popullsisë. Te buxheti i arsimit ka ndodh kjo: numrin total të të punësuarve e kanë aprovuar, mirëpo buxhetimin e buxhetit e kanë bërë në bazë të numrit të popullsisë dhe në këtë rast 186 punëtorë janë më shumë. Atëherë, neve na takon që duhet ta buxhetojmë edhe këtë staf të punonjësve me vlerë 1.3 milionë. Zvogëlimi apo efekti negativ i regjistrimit të popullsisë nga 56.000 në 41.000 banorë ka reflektuar edhe në buxhetin e shëndetësisë. Këtu kemi zvogëlim të buxhetit në të gjitha kategoritë në total 91.979€. Pra, buxheti për vitin 2026 është 2.360.000€ dhe kur e krahasojmë me periudhën e vitit aktual është ky zvogëlim dhe në këtë sektor 46 punëtorë janë më shumë, që ne duhet t'i buxhetojmë me vlerë 600.000€. Si përfundim, në bazë të qarkores së parë buxhetore buxheti shpërndahet në kategori ekonomike si vijon: Pagat 12.449.000€, që ka një rritje në raport me vitin aktual, prej 1.752.000€. Kategoria mallra dhe shërbime mbetet e njëjtë 2.761.000, shpenzimet komunali mbesin të njëjta 390.000, subvencionet i kemi zvogëluar për 10.000€ dhe inestimet kapitale janë 4.897.000€. Mbi bazën e këtyre kufijve e kemi përgatitur edhe KAB-in komunal si dokument, me objektivat, zotimet, faktorët financiarë dhe synimet e qeverisë sipas drejtorive. Ky dokument duhet të votohet dhe afati i fundit për dorëzim në Ministri të Financave është sot, më 30 qershor.

**Lirigzon Kastrati:** Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të ekzekutivit, kolegë anëtarë të kuvendit të komunës, përfaqësues të KFOR-it, qytetarë të pranishëm. Në emër të grupit të asambleistëve të LDK-së, i kemi disa çështje për diskutim. Para nesh është Korniza Afatmesme Buxhetore – dokument strategjik me rëndësi të lartë, i cili orienton planifikimin vjetor të buxhetit dhe pasqyron priorititetet dhe angazhimet tona për një zhvillim të

qëndrueshëm ekonomik dhe social. Ky dokument nuk është vetëm një tabelë financiare, por një pasqyrtë e qartë e angazhimeve tona për tri vitet e ardhshme. Këtu kërkohet vëmendje e kujdeshme dhe vlerësim kritik të dobishëm për ta bërë KAB-in një dokument real për zhvillim dhe drejtësi sociale. Shqetësim mbetet numri i lartë i punëtorëve në arsim, 186 punëtorë më shumë, që buxhetit të komunës do t'i kushtojë 1.3 milionë euro, po ashtu në shëndetësi janë 46 punëtorë më shumë, me vlerë 600.000€. Nga buxheti i komunës në total priten të mbulohen rrëth 2 milionë euro. Ulja e vlerës së investimeve kapitale për vitet pasuese i rrezikon projektet kapitale në vijim dhe nuk mundëson hapjen e projekteve të reja. Shpenzimet për 5 muaj të mbi 60% të mjeteve të shpenzuara nga fondi përmallra dhe shërbime dhe fondi për investime kapitale, rrezikojnë likuiditetin financier të komunës. Çka do të bëjë komuna edhe 7 muaj pa mjete buxhetore në këto dy kategori? Si do të mbulohen këto mungesa buxhetore?

**Defrim Kafexhiu:** Fillimi, pajtohem edhe unë me shqetësimet që i shfaqi Lirigzon Kastrati në emër të grupit të LDK-së. Shqetësues është fakti i formës së ndarjeve buxhetore në këto kategori dhe implementimi i KAB-it për tre vitet e ardhshme dallon prej herës të kaluar dhe është më i dëmshëm për komunën e Rahovecit. E dëgjova me vëmendje edhe drejtorin, të cilin e vlerësoj prej drejtorëve më të sinqertë në kuptimin e shfaqjes së shqetësimeve të përbashkëta që i kemi. Është shqetësues fakti që në arsim dhe në shëndetësi nuk janë buxhetuar prej Ministrisë së Financave komplet punonjësit e arsimit dhe shëndetësisë. Pavarësisht kësaj, më shqetësues është fakti që Komuna e Rahovecit e ka hapur një konkurs për 5 persona në shëndetësi, ku janë punësuar 10 vetë edhe përkundër faktit që 46 punonjës janë më shumë se sa që duhet të janë, jo vetëm shkaku i buxhetit, por edhe shkaku i mundësisë që ata e kanë për punë. Nëse stafi është i përbushur, duke marrë parasysh numrin e patientëve dhe numrin e banorëve të komunës me regjistrimin e ri të popullsisë, nuk e kuptoj pse komuna duhet të hap konkurs dhe të punësojë ende. Në një dëgjim buxhetor përmallrat për KAB-in e kam shfaqur të njëjtin shqetësim dhe arsyetimi i kryetarit ka qenë që, "tani e tutje apo edhe në mandatin tjetër do të jetë problem të punësohet dikush në këto dy sektorë, sepse stafi është i mjaftueshëm dhe konkurse do të ketë vetëm kur detyrimisht jemi të detyruar nëse dikush del në pension". Forma e konkursit për këta 5 punonjës ka qenë jo e nevojshme dhe në aspektin ligjor organet duhet ta vlerësojnë se a ka pasur shkelje aty, se si janë punësuar 10 persona në atë konkurs. Te investimet kapitale dhe te mallrat dhe shërbimet: Ne e dimë që sivjet, në vitin 2025, por edhe në vitin 2024 në Drejtorinë e Shëndetësisë përmallra dhe shërbime ka pasur mungesë të mjeteve financiare. Kjo gjë për vitin 2026 po rëndohet edhe më shumë, sepse kemi mungesë të theksuar buxhetit që t'i mbulojmë pagat e mësimdhënësve, të cilat nuk janë të mbuluara nga Ministria e Financave. Si do t'i sugurojmë lëndët djegëse në shkolla, mirëmbajtjen, higjenën dhe materialin tjetër shpenzues nëpër shkolla? Nëse edhe në këtë 6-mujor janë shpenzuar mjetet prej kategorisë mallra dhe shërbime, në vitin 2026 si do t'ja bëjmë? Çka ka bërë komuna kundrejt kësaj ndarjeje nga Ministria e Financave? A ka bërë kërkësë dhe a ia ka treguar këto shqetësime, sepse këto shqetësime janë të përbashkëta - janë shqetësime të qytetarëve. Sa është rreziku që nxënësit të mbeten pa shkumsa dhe pa higjenë në shkolla? Këto shqetësime po pres t'i shfaqin drejtori i Arsimit dhe drejtoresha e Shëndetësisë në këtë rast dhe jo vetëm drejtori i Financave, sepse nuk është mirë që komplet kjo përgjegjësi të bie te ky drejtor.

**Ilir Pallqa:** Përshtendetje për të gjithë! Te çështja e mbipunësimit: E e keni ditur ju si ekzekutiv që numri i punësimeve shkon në proporcione numrin e banorëve? Mendoj që po, sepse keni përvojë! A e keni ditur që numri i popullsisë po ulet? Po, sepse këtu po jetoni! A e keni ditur që obligimet barten prej investimeve kapitale? Po, se është rasti në Kamenicë, për shkak të gjeografisë po detyrohen t'i kërkojnë raste Ministrisë së Bujqësisë për t'i mbuluar investimet e mangta kapitale, për shkak të numrit të punësimeve. 2 milionë x 4, janë 8 milionë euro më pak përmallatin tjetër për investime kapitale strategjike. Do të thotë, institucioni i komunës po mbetet veç me paga dhe mëditje.

**Afrim Limani:** Faleminderit për pyetjet! Lirigzoni dhe Defrimi po thuajse i paraqitën të dytë shqetësimet e njëjta. Paraprakisht e thash që zvogëlimi i buxhetit është si rezultat i zvogëlimit të numrit të popullsisë. Kjo është formulë shtetëtore dhe faji është te formula që neve na ka goditur. E mira e kësaj punë është që numri i stafit është i aprovuar

dhe krijohet hapësira që ne ta mbulojmë me buxhet, sepse nuk mund t'i heqim 200 punëtorë. Mund të ndodh që vitin e ardhshëm të mos aprovohet dhe i bie që 200 punëtorë të dalin nga puna. E mira e kësaj pune është këtu, pra punëtorët janë aprovuar nga ministria. Ky buxhet ndahet sipas ligjit për financa publike dhe përgjejgësive dhe mos të harrojmë që ky ligj në vitin 2002 është aprovuar dhe deri më tani shumë pak është amandamentuar. Deri sa jemi në këtë situatë, jo vetëm komuna jonë, por edhe komunat tjera, atëherë ky ligj duhet të amandamentohet dhe kam shpresë që në këtë drejtim mund të bëhet diçka në vitin e ardhshëm. Ju informoj që sivjet mund të vështirësi, sepse thesari i ka tërhequr rreth 2 milionë euro për kontratën kolektive në arsim, 1 milion janë tëhequr nga mallrat dhe shërbimet dhe 1 milion euro të tjera nga investimet kapitale. Lirigzoni tha që po zvogëlohet vlera e investimeve kapitale, është e vërtetë kjo, por mos të harrojmë që para 2-3 viteve buxhetin për investime kapitale e kemi pasur 3.5 milionë e tani e kemi mbi 4.9 milionë. Ju informoj gjithashtu që sivjet opinionin e ZKA-së e kemi pozitiv dhe nuk besoj që do të kemi konkurrencë në përsitimin e grantit të performancës dhe sipas parashikimeve tonë, krejt shuma duhet të na takojë neve dhe në vitin 2026 gjithsesi do t'i kemi disa mjete shtesë në kuadër të investimeve kapitale.

**Kryetari:** Faleminderit! E dëgjova me vëmendje drejtorin dhe besoj që përgjigjet i ka shumë korakte dhe të sinqerta madje. Nga 38 komuna, 35 prej tyre kanë zvogëlim të numrit të banorëve. Zvogëlimi i numrit të banorëve ka krijuar një situatë jo të mirë, por qeveria e Kosovës ka mundur ta ndërrojë ligjin dhe të bën plotësim-ndryshim të ligjit për financat publike dhe përgjejgësive. Sivjet shorti ka ra që unë të jem anëtar i komisionit të granteve dhe 4 orë kemi bërë debat me Hekuran Muratin, pikërisht për temën e kontratës kolektive dhe për këtë situatë që është krijuar pas publikimit të regjistrimit të popullsisë. I siguroj qytetarët e Rahovecit, që këto shqetësimë që me të drejtë u ngritën në sektorin e arsimit dhe të shëndetësisë nuk do të ndodhin. E para, të gjitha shkollat do të kenë nxemje qëndrore, si dhe furnizim me lëndë djegëse. Përkundër tavaneve buxhetore që nuk i përcaktojmë ne, por është formula që i përcakton, është detyrë e ekzekutivit t'i gjejë praktikat e zgjidhjes së problemeve edhe përkundër kontratës kolektive, sepse nëse 2 milionë euro t'i merr shteti, nuk është aspak e lehtë. Nëse neve na ka marrë 2, Ferizajit 9, Suharekës 2.5, Gjakovës 4 etj... Secilën komunë thesari i shtetit e ka "sakatuar" për shkak të procedurave përmbarimore. Kontrata kolekfitve ka mbetur "rob" ndoshta edhe i inateve politike, ashtu siç po i shohim dhe i përjetojmë. Bile ministri në detyrë thoshte që ju duhet të bëni kallëzim penal ndaj atyre që i kanë nënshkruar kontratat kolektive, kjo i bjen që ndaj Hashim Thaqit e me fut në burg, e i thash që "o burrë kallxo si t'i nxjerim prej burgut ata" sepse po e tepron. Ka inate dhe në fund ka thënë që nuk dua t'i jap zgjidhje këtij problemi edhe pse asnjë kryetar komune nuk e ka nënshkruar kontratën kolektive, në të cilën parashihet që fondin ta sigurojë qeveria - përkatesisht Ministria e Financave. Është shqetësuese kjo situatë, të cilën duhet ta kuptojë secili qytetar, paravërisht a është i veshur me petkun e përgjejësisë apo jo. Nuk e kanë vullnetin politikë që kësaj pune t'i japin zgjidhje. Po e sqaroj edhe një herë që, ne jemi "për" kontratën kolektive, por është e papranueshme që ne t'i mbajmë pasojat financiare. Nëse komuna qenka e rrezikuar nga likuiditeti financier, atëherë të gjitha komuna e Kosovës janë, sepse kjo "e keqe" është duke ndodhur në secilën komunë. Popullsia po zvogëlohet si pasojë e migrimit të jashtëm dhe të brendshëm, si dhe si pasojë e asaj që njerëzit ndryshtë e planifikojnë familjen. Ministria na ka aprovuar të gjithë punëtorët, duke e ditur që po zvogëlohet numri i banorëve, rrjedhimisht e kanë ditur që po zvogëlohet edhe numri i nxënësve. Ne duhet ta miratojmë këtë dokument, sepse sot është afati i fundit për dorëzim dhe në fund të shtatorit votohet edhe buxheti, ku edhe përmbyllt puna e kuvendit komunal të Rahovecit. Deri atëherë, mund të kemi ndryshime në qarkoren e dytë buxhetore, siç mund të kemi lajme të mira edhe përfitimin e grantit të performancës, sepse nuk kemi konkurrencë në toplistë. Ky buxhet, sipas normativave përdoret vitin e ardhshëm. Në anën tjetër janë duke u rritur edhe të hyrat dhe planifikojmë që në 2028 të hyrat të bëhet rreth 3.5 deri 4 milionë dhe kjo e ndihmon përbushjen e zotimeve dhe projekteve. Zhvillimet ndodhin, proceset ecin dhe dikush se din se çka mund të prodhojë 12 titori, por qytetarët e dinë, sepse me rëndësi është ta dinë qytetarët dhe jo përshebull, unë e Defrimi.

**Ilir Pallqa:** Atëherë, u fol për kontratën kolektive prapë, ashtu siç u fol muaj pas muaji – qe 4 vjet sa jemi këtu. Ky është një borxh që një pjesë është paguar dhe ka mbetë edhe aq sa ka mbetur. Mbipunësimi është diçka që neve mund të na kushtojë vit pas viti dhe kjo gjendje është shumë serioze. Përpos që nuk do të ketë hapësirë për punësimë, gjithashtu do të ketë edhe ulje të investimeve kapitale, ndërsa ju thoni që janë rritë dhe prej 4 janë bërë 5, por pse mos të bëhen 7, sepse ne çdo vit do të jemi minus 2 milionë! Sa i përket ikjes së popullsisë, e dimë që po ikin vazhdimisht dhe jo veç prej Rahovecit, por si t'i ndalim ata që janë në mëdyshje të migrimit? I ndalim me investime kapitale dhe jo duke i punësuar ata që kanë mbetur. Në rregull, është interes partiak që t'i punësoni njerëzit e juaj, juve ndoshta ju bën mirë, por nuk i bën mirë potencialit zhvillimor komunal.

**Lirigzon Kastrati:** Drejtor, faleminderit për përgjigjet, gjithashtu edhe kryetarin e falënderoj. Te kontratat kolektive the që janë tërhequr 2 milionë euro nga buxheti i komunës. Në seancën e radhës, kërkoj të na informoni që këto 2 milionë a janë vetëm për kontratë kolektive? Sa janë shpenzime përmbarimore dhe gjyqësore? Sa i përket zgjidhjes dhe që thoni që s'na lejon ligji, jo kryetar ligji të lejon. Në momentin kur rasti iniciohet në gjykatë, ti mund të arrish marrëveshje gjyqësore dhe komunës mund të mos i shkaktosh shpenzime.

**Defrim Kafexhiu:** Korniza Afatmesme Buxhetore është një vendim i rëndësishëm, që e bën një planifikim dhe është një kornizë që kontribuon edhe një drejtësinë sociale, ashtu siç e përmendi Lirigzoni. Dua ta deklaroj votën që detyrimisht duhet të jem kundër këtij vendimi, shkaku që nuk është në interes të qytetarëve. E di që nuk varet prej ekzekutivit dhe prej neve, por është një problem që drejtori fajin ia la formulës, kryetari ministrit dhe unë besoj që edhe pse janë aprovuar koutat për shtimin e stafit në arsim dhe shëndetësi, faji është i joni, sepse e kemi ditur që numri i popullsisë nuk ka rënë brenda një dite e as brenda një viti. Ministria e Financave nuk mund ta di gjendjen më mirë se drejtori i arsimit dhe drejtorët e shkollave, se a ka nevojë për mësimdhënës apo jo, kur kërkesa bëhet prej juve. Tani ky arsyetimi juaj që ata na kanë aprovuar punëtorët, e në anën tjetër nuk kemi pare, më vjen keq, por nuk qëndron.

**Kryesuesi:** Atëherë, pas diskutimeve të shumta pikën e vendosim në votim. Kush është “për”... Kundër?... Abstenim?... Me 25 kuvendarë prezantë, 22 vota janë “për”, asnjë kundër dhe 3 abstenime, miratohet pika e dyte e rendit të ditës.

### 3. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve:

**Sinan Kryeziu:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë. Meqë insistova ta marr fjalën, por përshkak që iu dha përparësia opozitës nuk e mora. Unë e vlerësoj opozitën, sepse pa opozitë nuk ekziston ana praktike. U diskutuan punësimet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe e lidhës me faktin që kanë marrë punëtorë më shumë, për arsy se sipas raportit të fundit të regjistrimit të popullsisë, nuk përshtatet me numrin e popullsisë. Konsideroj që, praktikisht banorët mund të janë aty ku janë. Ne këtu në sallë, duke u nisur nga vetja kemi famijlarë në perëndim dhe juridikisht kanë qenë banorë rezidentë në Rahovec, kurse tani kanë bërë zgjidhje duke marrë nënshtetësi të dytë nëpër vendet e BE-së dhe janë detyruar fatkeqësisht të shpërngulen prej vendit tonë. Te Drejtoria e Shëndetësisë, nga ana procedurale janë udhëzimet administrative që është e paraparë që një mjek sa pacientë duhet t'i kontrollojë brenda orarit të punës së vet. Sa pacienta duhet t'i ketë një teknik medicinal. Nëse vjen dikush këtu dhe thotë që një mjek i bën tri kontrolla gjatë orarit të punës, me të vërtetë ka numër të shumtë të mjekëve. Konsideroj që punëtorët e QKMF-së kanë shumë pacienta dhe kur të vinë me fakte këtu, që me të vërtetë në QKMF nuk ka pacienta, atëherë punëtorët duhet t'i sistemojmë dhe jo t'i heqim nga puna, sepse me kontratë të përhershme ligji nuk e lejon që dikush të të thotë “shko te shpija”. Thjesht mund të bartet prej një lokaliteti në tjetrin, por jo të hiqet nga puna.

**Edona Kryeziu:** Përshëndetje për të gjithë! Një pyetje të shkurtër për Drejtorinë e Arsimit: Nga informatat që kemi, inspektoriat i arsimit të Prizrenit ka pasur një inspektim në DKA në Rahovec. Nëse mund të na informoni se për çfarë investimi po bëhet fjalë, para se të kërkojmë informata nga inspektoriat i arsimit në Prizren.

**Sejfullah Sejfullahu:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryetar, nënkyetar, drejtorë, kolegë asambleistë. Po ia filloj edhe unë me Drejtorinë e Arsimit. Rreth shkollës së re në Krushë, kemi pak problem me temperaturat brenda objektit. Së fundi, sipas informatave nga drejtori i shkollës, i kemi pasur tri alivanosje të nxënësve. Unë e di që ai projekt është i ministrisë dhe jo i komunës, por nëse ka mundësi të na siguron i projektin e këshillit të prindërve. Nuk e besoj që klimatizimi është në projekt, po nëse ka mundësi, kërkesa është për juve që ta bëni një zgjidhje. Një kompani e ka dhuruar një ventilim në sallë të profesorëve dhe më duket që edhe 11 të tjerë nevojiten. E dyta, objekti ka nevoj edhe për kamera. E treta, nesër fillon një turnir në Krushë të Madhe, turniri për "Dëshmorët dhe Martirët e Krushës". Sot po rregullohet edhe çështja e ulëseve për të paktën 300 shikues. Në turnir janë pjesëmarrës 64 ekipe. E ftoj kryetarin, por edhe juve drejtorëve, sepse do të jetë një eveniment madhështor.

**Defrim Kafexhiu:** Dua ta ngris një çështje shumë shqetësuese që lidhet me qytetarët e komunës së Rahovecit. Është çështja e kujdestarisë së barnatoreve që operojnë afër QKMF-së dhe për të cilat është një orari i kujdestarisë, që nuk po respektohet nga këto barnatoret që janë afër. Kemi parë shumë reagime për neglizhencën e këtyre barnatoreve dhe është e dhimshme që një komunë të mos ketë mundësi të paktën ta menaxhojë këtë orari të kujdestarisë, gjithashtu është e dhimbshme që barnatoret nuk po i përbahen këtij orari. Kam dëgjuar që e kanë një marrëveshje të mos operojnë gjatë tërë natës, por të operojnë deri në ora 01:00. Nuk e di a e din edhe Drejtoria e Shëndetësisë, por pas orës 01:00 nuk operon asnjë barnatore. Nëse një pacient ka nevojë për një shërbim – blerje të barnave, duhet të shkojë në komunën më të afërt dhe nuk besoj që një pacient në atë kohë e ka luksin të shkojë deri në Gjakovë. Kësaj pune duhet t'i bëhet zgjidhje. Unë kam biseduar me disa prej pronarëve të këtyre barnatoreve dhe ata e lidhin me punën e sigurisë gjatë natës. Kjo temë besoj që duhet të trajtohet në KKSB dhe që policia ta shpeshtoje patrullimin në afërsi të ambulancës, sepse është e vërtetë që gjatë natës mund të ketë pasiguri. Një propozim tjetër mund të jetë që, të paktën farmacistat të jetë të qasshëm me një numër të telefonit edhe nëse nuk e mbajnë hapur barnatoren në orarin e kujdestarisë. Në anën tjetër, nëse farmacisti nuk e hap telefonin dhe nuk ia kryen shërbimet pacientit, atëherë të gjobitet në shkallën më të lartë që e parashev rregullorja për gjoba e kuvendit komunal të Rahovecit. Krytar, e përmendëm më herët një konkurs ku ka qenë për 5 vetë dhe janë punësuar 10 persona. Meqë jemi para zgjedhjeve, kam qejf ta dëgjoj një koment rreth këtij konkursi.

**Kryetari:** Faleminderit kryesues! Sefa e ngriti një shqetësim dhe është e vërtetë që aty mungojnë kondicionerët. E kemi pasur një kontratë për klima dhe do të shohim me drejtorin e financave dhe të administratës se a mund të bëjmë zgjidhje për objektin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët "Bajram Curri" në Krushë të Madhe. Sa i përket kamerave, ata janë duke punuar në instalimin e kamerave dhe së shpejti i vjen radha edhe Krushës. Sa i përket konkursit në QKMF, procedurat kanë filluar në muajin shkurt. Aty përsëri ka vende të lira dhe besoj që tani do të hapim konkurs për mjek, sepse mjekët po shkojnë në specializim dhe më mirë 5 t'i mbajmë në Kosovë, se sa 5 të ikin prej Kosovës. Urime për ata që janë punësuar. Përndryshe, konkursi është i rregullt. Ju lutem mos më ndërhyjni, faleminderit për kontributin që po e jep, por vonë të ka dalë gjumi, sepse në shkurt kanë filluar procedurat. Tani është edhe fushatë dhe në rregull është. Më besoni që po më bëni nder. A e dini sa janë të kënaqur njerëzit me shërbime, sepse tani nuk ka mbingarkesë dhe gjithçka është në rregull. Ju po keni dëshirë t'i përzëmë edhe ata që kanë mbetur, këto janë politikat e VV-së dhe nuk ka faj asambleistja. Numri i atyre që po ikin dhe që planifikojnë të ikin është bukur i madh dhe me mundësitë tona duhet t'i ndalim, mirë që s'kam të drejtë të ndërhy sepse s'do të lija gurë po lëvizur veç që ta ndali një. Ne i kemi ndalur 5 dhe kur qarkorja buxhetore ka ardhur më vonë, sepse këtu ka procedura dhe duhet t'i presim edhe afatet e ankesave. Asnjë ankesë nuk ka qenë për një muaj afat dhe çdo ankesë që bëhet tani nuk ka kurrfarë legaliteti dhe legjitimiteti. Duhet ta keni një respekt për atë që është punësuar, sepse në çdo etapë punësohet dikush. Dikush është i pakënaqur, por jo dikush për interesa personale jep mesazhe se "ku me ditë çka paska ndodh në Rahovec". Asgjë nuk ka ndodhur, sot është e hënë – nesër e martë dhe jeta vazhdon, sepse çdo gjë është normale. E kam edhe një sqarim dhe është nevoja që ta tregoj një anekdodë. Ka prej tyre që e marrin vesh dhe ka që e marrin vesh pas dy viteve. "Një djalë i ri ish nisë ta kalojë drinin, ndërkohë e zen

shiu mbi varkën e vogël. Rritet niveli i drinit bashkë me stuhi. Djali në vete thoshte: A me shku te motra Humë, a te motra Havë?! Në një shelg u ndërpren varka dhe ky thotë: As te Hava, as te Huma, midis drinit mbi dy cunga". Së pari duhet ta dini, a jeni VV? A jeni VV a jo? Ku i keni çadrat? Nëse vërtetë e keni interes të subjektit politikë, me këtë mënyrë se si operoni, nuk e kuptoj, éshtë gjithçka e zakonshme. Nuk shkohet si "kufiri" pas vjelave. Procedurat e këtij konkursi ka qenë në shkurt, bille askush nuk ka besuar qe regjistrimi i ri i popullsisë zbatohet kaq shpejt. Ata vetë kanë thënë që duhet të presim, sepse duhet t'i bëjmë disa ndryshim-plotësimë të ligjeve. Ligji për financat publike dhe përgjegjësive nuk ka ndryshuar prej vitit 2002. Imagjinoni ku jemi sot, pa parlament të konstituar dhe vazhdojnë të bëjnë shaka me neve. Duhet të keni pak turp, sepse kryetari i komunës nuk i shpall konkurset e as Drejtoria e Shëndetësisë. QKMF-ja e ka një statut që éshtë miratuar në këtë kuvend. Nëse keni vërejtje dhe ankesa atëherë në rregull, por mos u kapni për tema familjare. Nëse hyjmë në tema familjare éshtë një urti popullore që thotë: "mos ta shohim punën n'crrikur n'crrikur se nana na del n'dritur". Mos të futemi andej, sepse unë shumëcka mund të kem informacion, por nuk jam i gatshëm ta ndaj me juve. Jemi miq, qytetarë dhe të zgjedhur, pra, të reflektojmë pak edhe pozitivitet. Ma përmendi një djalë të djalit të axhës dhe qe 5 vjet e ka kryer fakultetin. Turp, turp, turp. Nëse éshtë djali i djalit të axhës tim, a nuk bën që ai kurri të punësohet? Ju lutem, më keni hyrë edhe në familje, por unë kam kurriz të fortë dhe familjen e kam të qëndrueshme. Shyqyr që familja ime nuk merret me zhurmagjinjtë, të cilët dalin në publik e flasin palidhje. Ju kam thënë që mos ma "nxjerrni gjuhën" se unë nuk e kam vendin këtu t'i flas ato fjalë. Dikush ka dhënë jetë që të vie liria e këtij vendi. Smajl Latifi nuk éshtë adresë e skandaleve, nuk ka qenë kurr dhe nuk do të jetë. E dikush ka qëndruar aq anash sa që i ka disa thënie Viktor Hygo që thotë për luftën: dihet kush janë ata që sakrifikojnë e kush e gjëzojnë dhe zakonisht lirinë éshtë mirë që e gjëzojnë të gjithë, por e gjëzojnë edhe horrat.

**Vlora Vuçiterna – Çmega:** Faleminderit për fjalën, të nderuar të pranishëm! Krytar, ju po i shihni reagimet edhe po heshtni apo? Kjo heshtje nuk éshtë veç zhgënjesse, por tregues i mungesës së transparencës dhe mos gatishmërisë së juaj për të komunikuar me qytetarë. Tjetra, ani që je kryetar, të më ofendosh nuk ke të drejtë! A m'ka dalë gjumi herët a vonë, je dëshmitar ti dhe kolegët tjerë të pranishëm, se qysh në marrjen e mandatit si asambleiste në seancën e tretë e kam marrë fjalën dhe kam folur për konkurse, ku i keni pranuar 12 infermierë të juaj dhe ndër ta ka qenë edhe i afërm i juaj. Éshtë një fjalë, "më mirë vonë me më dalë gjumi, se sa kurrë", siç jeni ju ende në gjumë! Në konkursin e fundit për vende të lira pune për infermierë ishte paraparë një numër i caktuar pozitash, megjithatë në mënyrë të paspjegueshme dhe pa asnje njoftim zyrtar, këtij konkursi ia keni shtuar edhe 5 vende të tjera shtesë. Ky veprim i bërë në heshtje ngre pikpyetje të mëdha. Çështja tjetër që dua ta ngris éshtë ajo për laboratorin në QKMF. Pse laboratori nuk éshtë funksional qe një muaj e më shumë, përderisa ju keni nënshtuar kontratë me furnizuesin përfundim me reagjenta kimikë?! Qytetarët po detyrohet që me paratë nga gjepi i tyre, të shkojnë në laboratore private.

**Kryetari:** O popull, sa njeri thirret në emër të qytetarëve e nuk len gjë të keqe pa bë kundër tyre. Unë nuk fyj dhe kjo shprehja "qytetar" më duke dikujt po i konvenon të ndërtojë një alibi. Ju e dini që jam prej atyre që e kam karakterin tim. Më njobin qytetarët dhe qytetaret, si dhe edhe ata qytetarë që dikush thirret në ta, aktivizohen në rrëthana të caktuara e kiske po thuhet diçka përmes improvizimeve. Po ju tregoj që unë kurrë nuk kam qenë i fjetur edhe kur dikush vazhdimisht ka qëndruar në gjumë. Më vjen keq që në kuvandin e komunës ka njerëz, të cilët nuk përfaqësojnë asnjë dëshmi që kjo nuk ka të bëjë me retorikë politike, i ka marrë 100-200 vota, në rregull – i përfaqëson ata. Duhet të flas mendja para gjuhës dhe jo gjuha para mendjes. Këtu ka dikush interes ekskluzivisht personal dhe meqenëse dikush nuk i ka shkuar interes personal, tani o burra, o qytetarë, u bë kijemeti e u bë skandal. Gjithçka éshtë e zakonshme, unë i besoj shtetit tim. Te familjarët, ne jemi vetëm 4 familje me mbiemrin Latifi dhe nëse familja Latifi e ka ndonjë borxh, e ka vetëm ndaj atdheut që gjithmonë ia ka dhënë dhe do t'ja jepte edhe tani, shyqyr në kushte të tjera. Kokallat edhe pollavrat, familja Latifi dhe familjet tjera si falimja Latifit nuk i kanë përnder dhe nuk e kanë për obligim t'ia bëjnë dikujt. Nëse i hy dhe i bëj "gjeneral" familjes së saj, atëherë del "gjizë"

hesapi. Ju lutem, mos më ndërpreni, përndryshe e ftoj kryesuesin të jetë aktiv. Ka të drejtë kryesuesi të të nxjerrë nga seanca, mos më ndërprej. Fyerjet m'i bën ti në publik, unë jo. Unë nuk e fyj askënd. Po e përsëris, familja e jotja ndoshta del gjizë hesapi. Unë nuk jam i ulët e as i ligë, por, familja e jotja del “gjizë”, a e kuptove tani? Mos më ndërhyj kur unë e kam fjalën. Ti ke fol vazhdimisht për familjen time, por familja ime nuk është “gjizë”. A e din që unë ta njoh babën dhe t'i njoh krejt? Kërkoj nga kryesuesi që ti ta lirosh sallën dhe të shkarkohesh prej emocioneve dhe mos më ndërprej. Familja ime është “Bajrak” dhe ti nuk i njeh familjet e ndershme dhe patriotike. Ju kam thënë: mos ma nxjerrni gjuhën, sepse kjo nuk është hera e parë që ma nxjerrni gjuhën dhe kur ta nxjerri gjuhën unë shkoj deri në fund. Për interes të përgjithshëm, as familjen time nuk e dëgjoj, a e kuptioni? Prandaj, kur familja ime është në shënjestër vazhdimisht prej një “zhurmagjike” siç është kjo, nuk e toleroj. Do të ballafaqohesh gjatë me mua dhe ti s'do të jesh asambleiste, unë do të jem kryetar. Me të mira!

**Erem Spahiu:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Unë dëshiroj të ndalem pak te problemet që i kemi, jo te sharjet duke i humbur disa orë. Problemët në fshat me ujë të pijshëm. Rrugët fushore janë në gjendje katastrofike dhe tani veçse fillon sezona e korrje-shirjeve. I kam edhe dy pyetje për drejtorin e Urbanizmit: Një përrrockë aty, vijnë kompanit veç e bëjnë matjen dhe ikin, që 5 vite përrrocka është e pafinalizuar. Dua të diskutoj rrëth hidroizolimit që është bërë te pllaka e parkingut. Drejtor, cilat shtresa vijnë pas hidroizolimit dhe pse duhet ta mbushim shavor dhe ta ngjeshim, njëherit ta dëmtojmë hidroizolimin.

**Shqipe Kryeziu:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Përderisa i përkas fushës së arsimit, e kam një pyetje për drejtorin e Arsimit: Drejtor, tani jemi në prag të pranimit të nxënësve të rinj. Në drejtimet profesionale, sa nxënës duhet t'i kemi që të hapet një drejtim profesionale dhe jam e interesuar ta di nëse i lejohet “Ukshin Hotit” dhe “12 – Majit” të hapin drejtime profesionale, përderisa është IAAP në Rahovec?!

**Lirigzon Kastrati:** Një pyetje për Drejtorinë e Financave: Drejtor, rrëth çështjes së kompenzimit të Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale. Në seancën e kaluar kemi diskutuar edhe me sekretariatin, të cilët kanë thënë që i kanë dorëzuar listat. Në anën tjetër, 7 takime të komitetit nuk janë kryer! Anëtarët kanë kërkesë që kur do të ekzekutohen këto mjete? Te Drejtoria e Arsimit: Drejtor, në seancën paraprake kemi ngritë çështjen e bursave dhe plotësim-ndryshimet që i keni bërë në konkurs. E keni cekur që dy anëtarë të familjes nuk mund të marrin. E sheh pyetjen në procesverbal dhe të lutem për një përgjigje. Te Drejtoria e Bujqësisë: Keni bërë një intervenim te rruget fushore Hoçë e Vogël – Nagac dhe nuk janë vendosur gypat për kullimin e ujërave atmosferikë. Të jesh i bindur drejtor, që ajo rruge prapë do të dëmtohet.

**Shqipe Kryeziu:** Nënkyrjetar, kur duhet të hapet një kod buxhetor për Institutin e Arsimit dhe Aftësimit Profesional, që të hyrat të jenë drejtpërdrejt në atë shkollë. Kur lejohet?

**Faton Ramadani:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Kryetari besoj që është në ngjarje për kullimin e tokave bujqësore, që po bëhet një kanal aty. Është shumë me rëndësi për anën tonë, por pse nuk po punohet, pse është ndërprerë? Fakti që është ndërprerë, uji që po mbledhet prej Fortesës dhe prej fushave të Celinës, një pjesë të tokave bujqësore po i dëmton. Vitin e kaluar deri më datën 20, nëpër borë e shi kanë punuar. Tani kushtet klimatike janë shumë të mira, por nuk punohet. Duhet të punohet, sepse është mjaft e nevojshme për atë trevë. Tani është koha e korries dhe kemi problem për kambanja, sepse aty janë paraparë të bëhen disa ura për t'u dhënë qasje bujqëve në toka. Po e boj një kërkësë, që ju ta shikoni planin me operatorin që ai le ta vazhdon punën, sepse kushtet janë shumë të mira.

**Fahrije Lushi:** Faleminderit kryesues! Inderuar krytar, kolegë këshilltarë, të pranishëm. Nga mbledhja e kaluar i kam ngritur disa shqetësime dhe krytari më ka premtuar që në këtë mbledhje do të përgjigjet. Nëse ka nevojë do t'i përsëris shqetësimet e parashtuara. Në rregull, rrëth dëmeve që janë shkaktuar ndaj fermerit në fshatin Malësi e Vogël, më duket që kjo ka ndodhur në kohën e zgjedhjeve qëndrore. Është rregulluar kanali i kullimit, mirëpo në anën tjetër fermerit ia keni dëmtuar një pjesë goxha të madhe të punuar dhe të mbjellur me grurë (7 ari). Nga ju kam kërkuar një sqarim, se a keni biseduar me fermerin, a i keni kërkuar falje ose a keni menduar për ndonjë

kompenzim. Besoj që nëse do të ishte ndonjë fermer tjetër do ta merrnit më seriozisht, por ju e njihni fermerin shumë mirë dhe ndoshta e keni injoruar. Kërkoj pak përgjegjësi në këtë aspekt! Rruga "Kosova e Re" që është afër shkollës në Malësi të Vogël. Në atë rrugë, asnjëherë nuk është bërë asnjë intervenim. Kjo rrugë është mjaft e populuar dhe ka nevoj edhe për ndriçim publik. Shqetësimi tjetër ka të bëjë me fshatin Ratkoc. Aty është një kanal i kullimit të ujërave atmosferikë, në rrugën "Batalioni i tretë" dhe aty dikush e ka mbyllur atë kanal, te prona e tij private. Sa herë ka reshje të shiut, aty grumbullohen ujërat dhe futen në prona private përballë asaj rruge dhe atij kanali.

**Bejtullah Deliu:** Faleminderit i nderuar kryesues! Kryetar, zëvendëskrytar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë, media dhe të gjithë të pranishëm. Një pyetje për kryetarin! E kemi diskutuar temën e një formimi të një komisioni të jashtë për objektin e hotelit. A është mbajtur ndonjë takim, sepse si projekt-propozim ka dalur nga kuvendi. Deri ku ka shkuar kjo punë dhe a është marrë parasysh edhe kërkesa ime, që komisioni të zgjerohet me profesionistë të kualifikuar. Aty ka profesionist, por të ketë edhe të tjerë, sepse me të vërtetë aty do të ndërtohet një herë për dekada të tëra dhe besoj që duhet të ketë përkushtim. Pyetja e dytë: Po ndërlidhem me kolegun Defrim dhe nuk morëm përgjigje rreth çështjes së barnatoreve? Personalisht, gjatë mandatin e kam ngitur këtë shqetësim 2 po 3 herë. Herën e fundit kam shkruar edhe në facebook, jo që nuk është respektuar orari i vonshëm, por as orari zyrtar i rregullt atë natë nuk është respektuar. Një përgjigje që e kam marrë më herët, keni thënë që është një dëmin 50€ nëse nuk i përbahen orarit. A është e mundur që së paku barnat esenciale të jenë edhe në emergjencë, e cila punon 24/7. Besoj që është zgjidhje e mirë për qytetarët kjo. Në fund, nëse ka mundësi Drejtoria e Urbanizmit ta shikojë rrugën "Ali Sokoli" – "Përmeti" që janë disa gurë vazhdimisht aty, ndërkohë fëmijët dalin me biçikleta dhe rrezikohen, gjithashtu vulturat që kalojnë mund të godasin gurë dhe bëhet dëmi shumë i madh. Të rregullohet kjo pjesë aty dhe nuk besoj që është shpenzimi i madh, ndërsa dëmi mund të jetë i madh.

**Defrim Kafexhiu:** Me kast kisha dalë në foltore të flas këtë që dua të flas, por kam qejf të qëndroj përballë, përballë dhe kranar secilit prej juve, po ashtu edhe krytarit të komunës. Jemi Vetëvendosje, përderisa nuk deklarohemi ndryshe dhe jemi Vetëvendosje e cila ka bërë investime më shumë se çdo qeveri tjetër në komunën e Rahovecit brenda këtij mandati, më shumë se kur kryeministër e ke pasë kryetarin e partisë tënde. Jemi Vetëvendosje, e cila e ka mbështetur financiarisht 85% qendrën multifunksionale që sot do ta emërtojmë. Ka mbështetur dhjetra projekte që e kapi shifrën mbi 20 milionë € përbrenda këtij mandate. Jemi vetëvendosje, e cila ta ka zbardhë fytyrën në kuptimin e implementimit të projekteve të shumta – edhe këto asfaltimet që po ndodhin, rrugët fushore e kubëzim të rrugëve. Jemi kjo vetëvendosje që jemi munduar edhe ne këtu, që përmes kritikës ta nxisim punën dhe sa do pak ta zhvillojmë punën që e keni filluar. Kjo Vetëvendosje ka bërë "boll" për komunën e Rahovecit përbrenda këtij mandate dhe besoj që ti e din këtë. Është inat ta pranoni, e vërtetë. Për dallim nga ti, ne e pranojmë çdo projekt të mirë që bëhet, si dhe ju përgëzojmë për çdo projekt të mirë që e bëni. Kemi qejf që edhe ju ta përgëzoni Lëvizjen Vetëvendosje për këto investime që po i bën, pa ndihmën e të cilëve do të ishte problem të përfundohet, sepse 3 vitet e fundit vetëm sheshi e ka marrë shumicën e investimeve kapitale dhe projektet tjera që po ndodhin dhe projektet që kanë qenë dhe po realizohen në vazhdim, pa financimin e ministrive përkatëse të qeverisë së Lëvizjes Vetëvendosje nuk do të mund të përfundonin. Dicëka tjetër që dua të diskutoj: Ti kërkon prej neve, e unë kërkoj prej teje që të shkarkohesh prej emocioneve. Ne secili këtu mundohemi, paravërisht sa vota i kemi. Sistemi zgjedhor në sistemin demokratik ku ne jetojmë, që ju keni lustuar për këtë sistem demokratik, e kemi të drejtë e fjalës e sidomos që jemi të zgjedhur. Ti garon për kryetar komune, ne garojmë për asamble dhe ne mbledhim vota për asamble, ndërsa ti për kryetar komune. E thjeshtë është kjo punë dhe nuk është mirë të shfaqësh tendencë në kuptimin e përfaqësimit të qytetarëve. Këta 31 këtu jemi dhe secili prej neve e përfaqësojmë qytetarin, si dhe secili prej neve e kemi formën se si i shfaqim problematikat brenda komunës. Për konkursin e lartëcekur: Është vullnet i mirë i juaji që ta punësoni dikë, që mos të ikë jashtë. Në anën tjetër, ti je duke bërë gabim, sepse edhe për të bërë mirë duhet të dish. Nëse nuk di edhe me pasë qëllimin e mirë, mund të bësh dëm nëse nuk din. Janë punësuar 5 vetë dhe çka t'i

bëjmë atyre 20 të tjerëve që nuk janë pranuar dhe nuk e kanë dikë të njohur te ju që ta pranon! A e gjykon edhe këtë, 20 të tjerë që secili prej tyre tentojnë të ikin jashtë shkaku që në Komunën të Rahovecit nuk ka meritokraci. Është e vërtetë që procedurat kanë filluar në shkurt. Në rregull është të punësohen 5 vetë, në rregull është që të punësohet edhe dikush i familjes Latifi, por nëse forma që ne flasim të pengon, atëherë është diçka tjeter, se normal edhe ai që ka kryer fakultet e ka të drejtën e botës që të aplikojë dhe të punësohet. Kryetar, ti duhet të shkarkohesh prej emocioneve kur bisedon me neve. Në fund të fundit, nëse ka diçka ti mund të flasësh politikisht për neve, jo për familjet tona, sepse e zhvlerëson veten në kuptimin politik. Nëse ti del jashtë politikës dhe merresh me neve, nuk është mirë për ty, jo për neve. Po më vjen keq që duhet të them, por vetëm po e përsëris një fjalë që ti e the më herët. Në kuptimin politik të fjalës të punës së kryetarit, të përgjegjësive politike të ekzekutivit, puna juaj është “gjizë”.

**Kryetari:** Faleminderit Fahrije Lushi! Dëmi që po flisje ka ndodhur kur unë nuk kam qenë kryetar dhe nuk ka lidhje ajo punë. Sidoqoft e drejtë e tij është që të ketë edhe kualifikime, edhe pse nuk ka bërë mirë hiç, sepse familjarisht njihemi me të. Kemi marrë masa dhe nuk ka të bëjë me realitetin. Ekipet tona kanë qenë në terren dhe unë e kam respektuar dhe tani shpresojmë që do t'ja bëjmë një devijim, nëse bëhet fjalë për Samedin Zenën.

**Fahrije Lushi:** Jo kryetar, ky kanal i kullimit të ujërave atmosferikë është në hyrje te familja Lushi.

**Kryetari:** Atëherë nuk kam shumë dijeni për këtë gjë, e lus Përparimin dhe Albnorin. Përparimi e ka një problem shëndetësor në familje dhe sot mungon. E kemi një projekt të ndërtimit të rrugëve lokale dhe besoj që edhe kjo “Kosova e Re” është pjesë e kontratës. Operatori ka filluar te varrezat, do t'i bëjë edhe disa rrugë të tjera, diçka në Gexhë, diçka në Dejnë e diçka në Ratkoc. Ka vonesa pak, sepse nuk ka para – thesari i ka marrë, por, përkundër faktit që nuk ka para, disa operatojnë vazhdojnë të punojnë duke e ditur që më vonë mund t'i marrin. Mbyllja e kanalit të ujërave atmosferikë te rruga “Batalioni i tretë”: Interesant! E lus Norën le t'i dërgon inspektorët. Nuk jam në dijeni për këtë rast, sepse askush nuk ankuar deri më tani. Bejtullah, faleminderit shumë! Te hotel parku, në grup është shtuar edhe Fehmi Hoxha. Deri më tani i kemi pasur 2 takime, takimi i fundit ka qenë i përbashkët me komisionin e kuvendit. Ka dalur raporti përfundimtar, të cilin e kam nënshkruar dhe raporti i njëjtë me rekomandime për kritere është dërguar te komisioni për ankand i kuvendit të komunës. Komisioni i kuvendit besoj që nesë-pasnesë mund ta shpall ankandin. Ma merr mendja që është bërë një punë e madhe dhe shpresoj që parku do të ketë të ardhme dhe shpresojmë që të ketë ofertues në momentin kur shpallet ankandi. Punëve të mira unë ju them “punë të mbarë” dhe kjo temë nuk ka lidhje me politikë. Është e vërtetë që kuvendi i komunës ka nxjerrë një rregullore për kujdestarinë e barnatoreve. Prej mandatit tim të parë, ka vazhduar me Idriz Vehapin dhe tutje dy mandate të miat dhe është sfidë. Rregullorja parashev 50€ gjobë dhe i kemi dënuar disa herë. Jam takuar me ta dhe kanë ankesë që nuk kanë numër të mjaftueshëm të punëtorëve, si dhe çështja e sigurisë. Sa i përket çështjes së sigurisë, ne ia kemi zgjidhur, sepse kemi komunikuar me policinë. Janë disa arsyë që besoj që nuk janë të qëndrueshme. Bejtullah, do ta incizojmë gjendjen dhe do ta rishikojmë edhe një herë këtë situatë, sepse deri më tani asnjëherë nuk ka gjetur zbatim kjo rregullore e kuvendit.

**Vlora Vuçiterna – Çmega:** Faleminderit kryetar! Kjo që e tha Defrimi më herët, por edhe Bejtullahu, rreth mos respektimit të orarit nga barnatoret kujdestare. Për opinionin publik duhet të bëhet e qartë që farmacistët – kolegë e mi në mbledhjen e mbajtur kanë qenë kundër këtij vendimi. Unë në atëherë nuk kam qenë pjesë në atë lagje dhe drejtoresha e din shumë mirë që unë kam qenë prezente në mbledhje. Farmacistët kanë propozuar që kujdestaria të mbahet deri në ora 01:00 maksimum 02:00 dhe pas orës të jetë një numër i telefonit që të jetë në gjendje gatishmërie për pacientët. Pastaj, pasi ka ardhur vendimi, me sa e di unë është bërë një marrëveshje gojore me drejtoreshën që të funksionohet deri në ora 01:00. E dyta, unë nuk mund ta mbaj kujdestarinë deri në ora 07:00 përderisa jam femër dhe jam vet e katërtë femër aty, si dhe nuk na ofrohet kurfarë sigurie. Në fillim është e vërtetë që edhe inspektorët kanë dalë, gjithashtu edhe policët, mirëpo sot pas orës 10:00 nuk ka policë rrugës. Nëse këto kushte plotësohen, unë jam e para që do ta mbaj deri në 07:00 të mëngjesit.

**Kryetari:** Faleminderit Vlorë! I propozoj drejtoreshës që ta bëjë plotësim-ndryshimin e rregullores. Të vetmen marrëveshje që e kam bërë unë, është që ta respektojnë orarin dhe të gjithë ma kanë dhënë fjalën. Kur e kam parë që nuk po respektohet kujdestaria, inpektorati është angazhuar duke i dënuar ata që nuk e respektojnë orarin. Mendoj që duhet të ndryshohet rregullorja, ose duhet të fillojmë ta kemi një dëgjim me ta, bashkë me Komitetin për Shëndetësi. Përndyshe, nuk mund ta konsiderojmë të mirëqenë asnjë marrëveshje, pa e ndryshuar rregulloren. Sa i përket sigurisë, mendoj që policia duhet ta parashevë një pikë të përhershme kontrolli aty, sepse mund të ketë telashe. Sa i përket rrugëve fushore, janë duke vazhduar punët me rrugët fushore: Hoçë, Brestoc, Nagac, Retijë, kysmet në Opterushë, sepse parashihet me kontratë. Eqremi e din që është duke ndodhur projektin i madh i furnizimit me ujë të pijshëm. Çështjen e projektit me ujë të pijshëm ne e kemi bërë temë të madhe. E falënderoj Visarin që ka qenë jashtëzakonisht i angazhuar. Premtimet e ministrisë kanë qenë ndryshe, nuk ka qenë plani që komuna të futet në lojë financiarisht, sepse premtimet kanë qenë që Ministria e Ekonomisë, bashkë me KRU Gjakovën ta përfundojnë. Ministria e Kulturës e dini që 4 projekte na ka hequr dhe tani ministri Çeku është ndier keq dhe tutje ka dashur të bëjë diçka për komunën tonë. Unë nuk e përjashtoj asnjëherë lobinin që e keni bërë ju, e as ne. E kemi edhe stadiumin, në të cilin jemi bashkëfinancues, ani pse shuma financiare që e jadin ata është e pakrahasueshme. Bashkëfinancues gjithashtu jemi edhe në rrugët e qytetit. E kam falënderuar Liburn Aliun dhe Durmishin, por nuk i kam falënderuar si Vetëvendosje, por si njerëz të rëndësishëm të qeverisë, duke mos e identifikuar qeverinë, sepse qeveria nuk është treguar miqësore me komunat. Këta dy burra të dheut kanë dashur t'i ndihmojnë komunës sonë dhe nuk po lodhen për qeverinë, sepse as qeveri s'ka! Nëse do ta nënshkruaj një marrëveshje me zëvendësministrin, sepse ministri Fikrim Damka nuk ka të drejt të nënshkruajë, sepse është deputet. Në anën tjetër, Hysen Durmishi ka të drejtë të nënshkruajë, sepse ka qenë kandidat për deputet dhe nuk i ka fituar zgjedhjet. Sa i përket stadiumit, është në fazën e projektimit dhe jo të realizimit dhe për moment është në OSHP. Nëse hyjmë te politikat e Lëvizjes Vetëvendosje, faktikisht ndoshta pas 30 dite këta deputetë duhet të shkojnë në burg, nëse nuk e bëjnë kuvendin. Në burg, nëse nuk gaboj 5-6 vjet për një deputet. Në burg, prej kryetarit tim, së pari kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje e me radhë, sepse nuk e meriton Kosova këtë ndodhi dhe këtë bllokadë. Për fund edhe një herë po them: unë nuk shpalli konkurse, nuk bëj vlerësimë dhe nuk është dëshira ime veç të hapim konkurse, por ka nevoja specifike. Jemi të këtij vendi dhe duhet të mendojmë strategjikisht që ta ndalim dikë këtu. Ndërsa unë nuk krijoj probleme, nuk i iki problemeve, por jam pjesë esenciale e zgjidhjes së problemit. Kam zgjidhur shumë probleme dhe vazhdoj përsëri.

**Bejtullah Deliu:** Kryetar, te mungesa e ndërtimeve kolektive, a ka ndonjë shtytje për Hartë Zonale? Goxha kohë e gjatë ka shkuar dhe nuk kemi asnjë lajm rreth kësaj.

**Kryetari:** E di që nuk është përgjegjësi e mikut Liburn, por hartat zonale janë bllokuar krejt. Gjithçka është gati dhe nuk e di pse nuk e nënshkruajnë, ndërkohë ne duhet ta hapim shqyrtimin publik për t'i bërë edhe disa korrigjime të tjera. Jemi të interesuar ta hapim frontin e ndërtimeve të larta dhe Harta Zonale është qelësi i suksesit dhe shpresojmë që shefi i departamentit ta nënshkruajë, të jetë në debat publik dhe në kuvend.

**Hasan Përboqi:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryetar, nënkyetar, kryesues, kolegë asambleistë, drejtore të drejtorive, media, qytetarë. E kuptoj që tani janë shpallur zgjedhjet dhe sulmet politike sa vijnë e rriten. Janë të drejta dhe të padrejta, kur ka të padrejta përfaqësuesit e partive politike duhet të dalin dhe ta sqarojnë. Miqësish po ju jep një sqarim për kolegun Defrim, në lidhje me investimet e bëra nga qeveria Haradinaj për aq sa ka qenë 1 vit e gjysmë apo 2. Sa ka qenë kryeministër Haradinaj ka nisur dhe ka përfunduar rruga e "Hamocit", ka nisur dhe ka përfunduar rruga "Xërxe-Ratkoc", është përfunduar projekt i transitit mbi qytet, është përfunduar palestra (pas zhagities 15 vite), rruga "Maja e Shkodranit", shtegu i ecjes nën "Majën e Shkodranit". Ka edhe projekte të tjera, por të paktën këto po i mbaj në mend. Nuk harrojmë i harrojmë as projektet tjera, si dhe nuk i dalim në kundërshtim asnjë projekt, sepse është për të mirën e qytetarëve. Nuk e harrojmë faktin që kur ka nisur Qendra për Inovacion, dikush ka dalë kundër, duke thënë që "kjo është gabim". Nuk e harrojmë gjithashtu faktin që kur ka dalur ministria

që do ta mbështes këtë projekt, dilnin dhe thonin “jo, tani është mirë”. Kështu që, çdo gjë që vjen në të mirën e qytetarëve është e mirëseardhur dhe nuk i dalim kundër asnje centi. Nuk harrojmë t'i falënderojmë, kryetari i falënderoi, ndërsa këta tani nuk e falënderojnë Liburnin, sepse ka “dalur dursh” dhe nuk është më në parti.

**Kryetari:** Ju keni të drejtë të flisni për parti, unë flas si kryetar komune. Këto gjëra që i tha Hasani, di edhe unë t'i them. Por, çdo pune të mirë që bëhet në këtë vend, duhet t'i gjithë faktit dhe suksesit.

**Merisa Sharku:** Përshëndetje për të gjithë! Ku ka arritur çështja e Hartës Zonale, sepse po zvarritet shumë dhe punët po mbisin anash. Qytetit të Rahovecit i duhet zhvillimi dhe ndërtimi kualitativ. Them që, çkado që punohet duhet të jetë kualitative, sepse nuk ka dy muaj që është përfunduar asfaltimi i rrugës “Gëzim Hamza – Piktori” dhe sot duke ardhur këtu, kishte bllokim dhe e vërejta që diçka po rinovalohet. Pse po ndodh kjo? Tjetra çështje është rruga afër gjimnazit që kalon te “Ibrahim Rugova”. Aty ka shpejtësi të madhe të automjeteve dhe motorave. Përderisa nuk ka ardhur ndonjë fatkeqësi, aty duhet të rritet patrullimi dhe patjetëri duhet të ketë “policë të vdekur”, si dhe në fillim të rrugës te këndi është mirë të jetë një pasqyre këndore.

**Kryetari:** Merisë, për Hartën Zonale folëm, për peshën e saj, rolin dhe çka përfaqëson ajo. Të gjitha ndodhitë jemi duke i analizuar dhe jemi duke e pritur. Te rruga “Gëzim Hamza” as unë nuk jam i kënaqur, këta “Lika” janë duke ia rregulluar një pusetë “Benitës” dhe prandaj ia kemi ndërpren kontratën kompanisë në fjalë. Sa i përket barrierave në rrugë, na po i vendosim ato edhe pse shpejt po i heqin. Këto rrugë që po ndërtohen tani, do të bëhen me kualitet dhe i besoj punës që po bëhet sot, sepse ka një vëmendje të shtuar. Shyqyr që po i shtrojmë me “ibërcuk”, po “ibërcuku” është i fortë dhe kualitativ. Sa i përket motorave: mos e harroni që numri i të vdekurve me motora në qytetin e Rahovecit, që nga paslufta është 13 dhe atë të gjithë të rinj. E ftoj policinë për vëmendje të shtuar, sepse ka mundësi që shumica prej tyre nuk kanë as patent shofer.

**Sejfullah Sejfullahu:** Faleminderit kryesues! Nuk e pata mend të flas e as të replikoj me Hasanin, por punëve të mira çdo herë i kemi thënë. Ne e kemi hap edhe një muze dhe jemi gjuar për të gjitha investimet e mira. E kam një hatërbetje: Tre vjet e kam “shqyer” fytyrë për një rrugë në Celinë te shtëpia muze dhe një rubrikë e bërë ai gazetari dhe pas një javë u përfundua! Sido që të jetë, më vjen mirë që po bëhet kjo punë, por nganjëherë mendoj që rrugën time duhet ta ndaj me atë gazetarin apo si?

**Kryetari:** Rrugën në Krushë e ka “Mendi” dhe ka vështirësi aty. Këta kanë fuqi dhe vullnet për punë “pa para”, sepse edhe në atë rrugë aty na kanë marrë paratë. Kjo rrugë po bëhet prej kërkesave të Krushës dhe ajo rrugë është pjesë e kontratës. Është shpallur procedura edhe për rrugën Fortesë – Celinë dhe besoj që do të bëhet një rrugë e mirë. Ju falënderoj për kontributin.

**Defrim Kafexhiu:** Ta lëmë anash aspektin politik dhe mbi arsyen e bashkëpunimit propozoj që, pika e fundit “Vendim për emërtimin e Qendrës për Kulturë, Arte dhe Inovacion “Avdullah Bugari”, të vendoset si pikë e katërt e rendit të ditës.

**Kryesuesi:** Atëherë, shkojmë në pauzë dhe rikthehem pas një ore.

#### **4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për konstituimin e të drejtës së kalimit (servitutit sendor), ZK Rahovec:**

**Afrim Oruqi:** Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, kolegë drejtore, të nderuar anëtarë të kuvendit. Me propozim të kryetarit, para jush keni vendimin për konstituimin e të drejtës së kalimit (servitutit sendor), ZK – Rahovec. Me këtë vendim miratohet kërkesa e kërkuesëve të përmendor në kërkesë. Është një parcelë e komunës në anën e djathtë të rrugës Rahovec – Suharekë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 48 ari e 8 m<sup>2</sup> dhe prej pjesës së përgjithshme i ndahet një pjesë për të drejtë kalimi. Në terren është rrugë faktike dhe këta qytetarë veçse kalojnë në të.

**Egrem Spahi:** Këtu po i shoh dy rrugë. Unë në një seancë të vitit të kaluar e kam kërkuar një parking për të gjithë ata që shkojnë për ceremoni mortore. A ka mundësi që këtu të jetë një rrugë dhe jo dy, siç po shihen në gjeoportal.

**Afrim Oruqi:** Në terren në drejtim të Suharekës, shihen që janë dy rrugë të kalueshme. Është e pamundur kjo, sepse kjo e drejtë kalimi është t'ju sigurohet rruga vetëm tri parcelave. Përndryshe, kjo rruga e parë që është më e

gjatë është rrugë që e kalojnë fermerët dhe janë disa dhjetëra hektarë në atë drejtim. Në pyetje rreth parkingjeve: ne tani jemi në fazën finale dhe kemi hartuar një projekt dhe shumë shpejt do të bëhen rreth 50 parkingje për vetura.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Nëse nuk kemi pyetje të tjera, pikën e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Atëherë, me shumicë votash (20) votohet pika e katërt e rendit të ditës.

## **5. Shqyrtimi dhe mratimi i vendimit për miratimin e Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijëve 2025-2028:**

**Nënkyetari:** Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të kuvendit, drejtorë dhe të gjithë ju të pranishëm. Para vites e keni Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijëve 2025-2028. Këtë plan desha ta prezantoj me fjalët e mia, por këta më thanë lexo. Po lexoj: Ky plan është ndërtuar mbi vlerat e bashkëpunimit, përfshierjes dhe përgjegjësisë të përbashkët ndaj brezit të ri. Përfaqëson një orientim të qartë për komunën tonë për përbushjen e të drejtave themelore të fëmijëve në arsim, shëndetësi, mbrojtje, pjesëmarrje dhe mirëqenie. Procesi i hartimit të këtij plani ka qenë i hapur dhe gjithëpërfshirës dhe është realizuar me mbështetjen e MAPL-së, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me organizatën Syri Vizion dhe Nevo Koncept. Ky plan është përfshirë në rend dite si dëshmi e gatishmërisë sonë për të ndërtuar politika më të kujdeshshme dhe më të ndjeshme ndaj fëmijëve tanë. Ju ftoj që ta miratoni këtë plan, si një angazhim të përbashkët dhe të sigurohet që çdo fëmijë në Rahovec të rritet në një ambient më të sigurt dhe më përkrahës.

**Kryesuesi:** Faleminderit nënkyetar! Nëse nuk kemi pyetje të tjera, pikën e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Atëherë, me shumicë votash (20) votohet pika e pestë e rendit të ditës.

## **6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 nr.47/25, i datës 29.4.2025, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV):**

**Afrim Oruqi:** Bazuar në rekomandimet e MAPL-së, para jush keni vendimin për shfuqizimin e vendimit 01 nr.47/25, i datës 29.4.2025, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. Ju ftoj që pas shqyrtimit ta votoni këtë propozim-vendim.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Nëse nuk kemi pyetje të tjera, pikën e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Atëherë, me shumicë votash (20) votohet pika e gjashtë e rendit të ditës.

**Kryesuesi:** Të nderuar anëtarë, kërkesë e kuvendarit Defrim Kafexhiu ishte që pika shtesë që është për sot, të vendoset tani në renditje. Nëse jeni të pajtimit me lejen tuaj.

## **7. Vendim për emërtimin e Qendrës për Kulturë, Arte dhe Inovacion “Avdullah Bugari”:**

**Kryetari:** Para se të futet në rendi dite kjo pikë, ia dhamë disa argumente dhe arsyetime. Po ju tregoj kështu: me Avdullah Bugarin, Mizahir Ismën, Bylbyl Oruqin, kemi qenë pjesë e këshillit të të rinjve të lëvizjes populllore për Republikën e Kosovës 1990. E njoh që nga ky vit dhe pastaj ai e ka dëshmuar edhe në aktivitete të tjera dhe në UÇK. Avdullah Bugari i ka pasur edhe disa afinitete në kulturë, në art dhe në humor. Ka qenë djalë korrekt, i singertë, trim dhe i përfshirë në epokën më të artë të UÇK-së, në luftën për liri. Është vrarë më 17 korrik 1998 dhe është dëshmori i parë i njësisë që ka operuar në qytet dhe përreth qytetit (shtabi “Arti”). Është nder i madh që kuvendi i komunës së Rahovecit e nderon një objekt të rëndësishëm të artit, kulturës dhe inovacionit. Avdullahu i ka udhëhequr demonstratat në solidaritet me popullin e Drenicës dhe ka qenë në ballë të demonstratës kur është sulmuar familja Jashari. Pra, bëhet fjalë për një nga djemtë më të mirë të Rahovecit dhe jo vetëm Rahovecit. Mendoj që, në mënyrë solemne me një duartrokitje do të ishte tepër fisnikë, në prag të Epopesë së UÇK-së korrik 1998, ta emëtojmë Qendrën për Kulturë, Arte dhe Inovacion “Avdullah Bugari”.

**Lirigzon Kastrati:** Të nderuar anëtarë të ekzekutivit, kolegë anëtarë të kuvendit. Natyrish që kur të flitet për dëshmorë e martirë, gjaku i derdhur për liri obligon brezat dhe në emër të grupit të asambleistëve të LDK-së pajtohem plotësisht me këtë vendim. Sot, nuk po marrim një vendim të zakonshëm, por një vendim që përfaqëson nderim, kujtim dhe angazhim të përhershëm për vlerat më të larta të kombit dhe qytetit tonë. Ky vendim nuk është akt simbolik, është akt i përkujtimit të denj dhe i domosdoshëm për një nga figurat më emblematike të Rahovecit dhe lëvizjes për liri të Kosovës, heroji i kombit Avdullah Bugari. Ai qëndroi në krye të betejës së Rahovecit dhe ra heroikisht më 17 korrik 1998 po në

këtë betejë, duke komanduar me guxim për fitore. Përvec armës, Avdullahu kishte edhe një tjetër armë të fuqishme: kulturën dhe artin, të cilat i përdorke për t'i bashkuar njerëzit, për ta ngritur moralin dhe për ta mbajtur gjallë shpresën. Prandaj, është mëse e natyrshme dhe e merituar që Qendra për Kulturë, Art dhe Inovacion në Rahovec ta mbaj emrin e tij, për ta vazhduar fryshtës e tij krijuese dhe organizative. Prandaj, le ta miratojmë këtë vendim me krenari dhe përgjegjësi, si një hap i vogël përballe një sakrifice të madhe. Lavdi heroit Avdullah Bugari, lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit.

**Hasan Përboqi:** Ashtu siç e thanë edhe parafolësit, kryetari dhe kolegu Lirigzon. Sot, këtu jemi mbledhur që përpos punës që e bëjmë si asambleist, para vetes e kemi një pikë të veçantë. Një akt dhe një nderim – emërtimin e qendrës për Kulturës, Art dhe Inovacion, me emrin e një biri të shquar të këtij vendi, dëshmorit dhe heroit, si dhe emrin e një artisti me shpirt siç është “Avdullah Bugari”. Me këtë akt simbolik, por me vlerë të thellë ne e lidhim përgjithmonë emrin e tij me krijimtarinë, me dijen dhe me ato vlera të cilat ai e dha jetën. Qendra që sot e merr emrin e dëshmorit “Avdullah Bugari” do të jetë jo vetëm një vatër kulture dhe zhvillimi, por edhe një kujtesë e gjatë për të rinjtë tanë, që të dihet që liria nuk ishte e dhuruar, por u fitua me sakrificë të madhe. Lavdi e përjetshme për dëshmorin, “Avdullah Bugari”. Emri i tij do të kujtohet përherë, sa të ketë popuj që jetojnë në këto troje.

**Bejtullah Deliu:** Po e nisi një fjalim për nder të figurës së madhërishtë të dëshmorit, heroit, humoristit, shokut dhe aktivistit të madh të shquar të kohërave të ndryshme. Falënderoj zotin që më mundësojë të jetoj shumë fazë transitore-sfiduese për Kosovën, që për një periudhë të shkurtër kohore kanë ndodhur shumë ndryshime dhe përfatët të mirë kur koha punonte në favor të Kosovës. Përjetova shtypjen sistematike të sërbisë mbi popullin të shumicë të Kosovës në njëren anë dhe në anën tjetër përjetova mosnënshtrimin ndaj kësaj shtypjeje, duke e manifestuar këtë kundërshtim me organizimin e vazhdueshëm të demonstratave të ndyshme dhe protestave të vazhdueshme, deri te kryengritja më e madhe dhe më e çmendur, pra formimi i UÇK-së. Kjo ushtri që buronte nga vet populli, nuk mund të duronte më nënçmimin e vazhdueshëm që e përjetonim si shumicë absolute në Kosovë. Në të githa këto organizime: demonstrata, protesta e deri te kryengritja e armatosur, Avdullah Bugari ishte në rreshtin e parë, apo thënë ndryshe në vijën e parë të frontit. Rahoveci me rrëthinë në çdo moment i qëndronte hap pas hapi Drenicës heroike, në krye me komandantin Adem Jashari, ku lavdia mbi këtë familje do të jetë e përjetshme dhe heroit të gjallë të shokut të ngushtë të Adem Jasharit, gjeneralit Sami Lushtaku. Po ashtu, ishte afér heronjve të Dukagjint, gjegjësisht Gllogjanit nën udhëheqjen e dëshmorit Luan Haradinaj dhe vëllezërve të gjallëm, heronjve të sotit, Ramush e Daut Haradinaj. Rreshtimi i Rahovecit në këto anë të Kosovës ishte jo vetëm me fjalë, por me vepra. Rahoveci i ka dalë në ndihmë në luftime të ndryshme me gjeneral Xhelal Hajda – Tonin, Selajdin Mullabazi – Mici, Mensur Zyberaj, Feim e Bedrush Gashi, Gëzim Hamza – Piktori e Bekim Sylka, kreatori i pavarësisë së Kosovës, prof.dr. Ukshin Hoti dhe prof.dr. Sabahajdin Cena, si dhe heroi i gjallë Ismet Tara. Kësaj rruge nuk i është ndarë as dëshmori Avdullah Bugari, për të cilin jemi sot këtu. Rahoveci është vend i vetëm si zonë urbane ku UÇK-ja kishte hyrë në luftë frontale, duke sulmuar ushtrinë serbe me një luftë të përgjakshme me ditë të tëra. 17 korriku 1998 ishte dita kur trimat të veshur me uniformë me emblemë të UÇK-së, ia mësyan qytetit duke e kontrolluar pothuajse në tërësi. Këtë vullnet të madh e shfaqi më së shumti dëshmori i orëve të para të 17 korrikur të përgjakshëm, pra, Avdullah Bugari, i cili e ripërsëriti historinë e Mic Sokoli, i cili i doli me gjoks gjylës së topit. Avdullah Bugari veproi njëjtë duke luftuar me armiqëtë serbo-çetik ballë për ballë. Populli serb është dhe do të mbetet tinzar e hipokrit, ata nuk të dalin përrpara, por të vrashin prapa shpine. Kjo gjë ndodhi edhe me dëshmorin Avdullah Bugari, sepse ndryshe nuk do të mundeshin ta luftonin këtë hero. Sikur që e thash në fillim që e falënderoj zotin për përjetimin e këtyre ndryshimeve, tanë e falënderoj zotin që në emër të PDK-së degra Rahovec dhe në emër të asambleistëve të kësaj partie, që me një ngritje dore të votohet kjo pikë shumë e rëndësishme e rendit të ditës. Do të votohet për tempullin e dijes, i cili do ta mban emrin e të madhit Avdullah Bugari dhe me shpresë që nga këtu të dalin edhe shumë Avdullahë të tjerë. Pra, luftën, lirinë e pavarësinë e fituam, por e kemi një kundërshtar që ditë e natë punon për të na dëmtuar. E kemi rastin e Hagës, ku na mbahen padrejtësishët ata që e themeluan UÇK-në dhe e shpallën pavarësinë, Hashim Thaqi dhe Kadri Veseli, si dhe shokët e tyre. Një gjë duhet ta di ky popull: nuk duhet ndalur kurrë së punuari dhe së përkrahuri

njerëzit e pushkës, sepse ata që ishin të gatshëm ta japid jetën një herë, ata janë të gatshëm të mbesin dëshmorë çdo herë. E dashur familje e dëshmorit Avdullah Bugari, urime emërtimin i Qendrës për Kulturë, Arte dhe Inovacion me emrin e bashkëshortit, prindit, gjyshit, shokut, humoristit dhe dëshmorit Avdullah Bugari. Lavdi dëshmorëve dhe martirëve të kombit dhe mirënjohje për të gjithë kontribuuesit e UÇK-së.

**Defrim Kafexhiu:** Kur të jepet fjala si i fundit, është më e vështirë t'i përzgjedhësh fjalët, sidomos në rastet e tillë si sot. Po ndihna i emocionuar duke i dëgjuar parafolësit e mi, duke folur për dëshmorin e parë, për Avdullah Bugarin, emrin e të cilit sot po e vendosim me shumë krenari në Qendrën për Kulturë, Rini, Arte dhe Inovacion. Si gjeneratë e re, po ju marr lakmi secilit prej jush që folët dhe që e keni pasë nderin të jetoni njëkohësisht me dëshmorin dhe heroin tonë, Avdullah Bugari. Unë e di që mitet nuk janë ndryshe dhe ngjarja heroike e rënies së Avdullah Bugarit do të jetë një mit për të ardhmen, për të gjithë ata që do të jetojnë në këto troje. Ngjarjet e tillë sikur ky vendim, janë historike, sepse kultivimi i vlerave të luftës është njëra prej gjërave që neve na bënë krenarë dhe më përbashkues si popull. Jemi të ndarë në aspekte politike dhe në ide të ndryshme të zhvillimit të jetës së përditshme, por te puna e luftës besoj që e ndajmë një mendim dhe jemi për promovimin dhe zhvillimin e vlerave. Me emërtime të tillë ne po e bëjmë një shenjë, që nuk do të harrohet asnjëherë dhe ne do të ndihemi shumë krenarë që atë emër do ta gëzojë qendra për kulturë për të ardhme dhe për të gjithë nxënësit që do t'i zhvillojnë aktivitetet e tyre në këtë qendër. Qoftë i paharuar kujtimi për Avdullah Bugarin. I përjetshëm emri i tij, por edhe Kosova.

**Sejfullah Sejfullahu:** E vërejta që po flasin vetëm shefat e grupeve, por kur e përmendi Defrimi që tha që “ne nuk e kemi njojur Avdullah Bugarin”, po i jap vetes pak të drejtë të flas. Ndonjëherë kur po “shtyhemi” e po bëhem “lëmsh” po them vetmevete “më mirë po të kisha kandiduar fare”. Në anën tjetër, kur po i diskutojmë temat e tillë, vendime të mira, po them mirë që jam. Avdullahun e kam njojur në luftë, por do të flas si koleg arti. Ne kemi qenë humorista të atëhershëm dhe ju premtoj që kur të bëhet hapja e qendrës kulturore, do të mundohem ta ekzekutoj sa më mirë një prej pikave të humorit që e kemi bërë bashkë. Lavdi!

**Ilir Pallqa:** Emërtimi i qendrës për kulturë dhe rini, me emrin e dëshmorit “Avdullah Bugari”, është vendim me peshë historike dhe simblike. Avdullah Bugari ka qenë dëshmori i parë i qytetit tonë, që ra heroikisht në betejën e lavdishme të Rahovecit, betejë që hapi rrugën për ndërkombëtarizimin e luftës sonë për liri. Ai nuk ishte vetëm luftëtar, ishte artist dhe aktor i dashur për banorët e Rahovecit dhe emri i tij për qendrën e kulturës nuk është vetëm nderim për të kaluarën, por është frymëzim dhe mësim për artistët, rininë dhe për ne, se liria është arti më i shtrentjë dhe më me vlerë se vetëjeta për një artist. Këtë nuk po e them unë, e ka thënë Avdullahu me jetën dhe veprën e tij. Votimi “pro” na nderon vene dhe pastaj vendin. Unë votoj “pro” për ta nderuar veten dhe të gjithë neve.

**Kryesuesi:** Të nderuar anëtarë të kuvendit, pas diskutimeve dhe fjalimeve për dëshmorin Avdullah Bugari, pikën e vendosim në votim. Kush është “për”?... Unanimisht, me 23 vota “për” miratohet vendimi për emërtimin e Qendrës për Kulturë, Arte dhe Inovacion me emrin “Avdullah Bugari”. Në nderim të dëshmorit “Avdullah Bugari” ju lus që ta nderojmë me një minutë heshtje... Lavdi!

## 8. Shqyrtimi i raportit 6-mujor, janar-qershor 2025 të kryetarit të komunës:

**Kryetari:** Faleminderit! Urime për emërtimin e Qendrës për Kulturë, Arte dhe Inovacion me emrin e heroit “Avdullah Bugari”. Emri i babës nuk do të figurojë, por për biografi e kemi vendosur ashtu. Lavdi për të dhe për të gjithë shokëve e martirëve kudo që kanë ra në luftën për liri. Raporti 6-mujor i punës së kryetarit të komunës dhe le të themi i drejtorive të Komunës së Rahovecit, sipas ligjit ky raport paraqitet para kuvendi dhe është i publikuar në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Rahovecit. Është i qasshëm për publikun, i protokoluar, i vulosur dhe nënshkruar nga kryetari i komunës. Raporti e ka pjesën e përbajtjes, hyrjen dhe prioritetet e programit qeverisës. Zyrat e kryetarit të komunës: Zyra ligore, zyra e burimeve njerëzore, zyra e prokurimit, zyra për informim dhe marrëdhënie me publiku, zyra e auditimit të brendshëm, zyra komunale për komunitete dhe kthim dhe zyra për përfaqësim ligjor. Këto raporte gjashtëmuajore kryesisht kanë statistika, shifra. Materialin e keni përpara dhe besoj që mund ta lexoni. Në raport janë edhe të gjitha aktivitetet, përkushtime, të arriturat, sfidat dhe planet e të gjitha drejtorive të komunës. Është lajm i mirë që reportin e

paraqesim brenda afatit dhe kjo është dëshmi e përkushtimit tonë për të qenë të hapur me qytetarin. Jam i hapur për vërejtje, vlerësimë ose pakënaqësi, sa i përket raportit 6-mujor të punës së kryetarit të komunës.

### **9. Shqyrtimi i informatës rreth aktivitetave të KKSBS-së për 6 - mujorin e parë të vitit 2025:**

**Kryetari:** KKSBS-ja e ka një plan vjetor të punës dhe sipas planit i zhvillon aktivitetet e saj, i mban takimet dhe i nxjerrë vlerësimet. Mund të ketë edhe rekomandime që tutje mund të përkthehen në vendime. Rol i KKSBS-së është jo i vogël, kryetari i komunës e kryeson mbledhje dhe aty përfshihen: Policia, ojq-të, përfaqësuesit e bizneseve, bashkësítë fetare dhe fsk-ja. Rol i KKSBS-së është që diskutimet e bëra mos të mbesin vetëm në sallën e kuvendit të komunës, por të zhvillohen këto aktivitete edhe nëpër qendrat të tjera. Mbledhjen e fundit e kemi mbajtur në Krushë të Madhe dhe herën tjetër do të mbahet në Ratkoc dhe pastaj do të kthehem i në Rahovec. KKSBS-ja diskuton tema të rëndësishme të rendit publik, për sigurinë tonë të përgjithshme dhe për plot aspekte të tjera që në një mënyrë ose tjetër ndërlidhen me çështjet e sigurisë. Ju kujtoj faktin që anëtarët e KKSBS-së janë me mandat 4-vjeçar dhe zgjidhen në bazë të një thirrjeje publike dhe pastaj aplikojnë. Sipas udhëzimit administrativ, saktësisht dihet se kush duhet të jetë anëtar i KKSBS-së. Jo me emra e mbiemra, por prifilet ose autoritetet që duhet të jenë pjesë e KKSBS-së.

### **10. Shqyrtimi i raportit rreth aktivitetave të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, për 6-mujorin e parë të vitit 2025:**

**Kryesuesi:** Këshilli i fshatit kanë qenë të ftuar, por nuk janë prezantë.

**Kryetari:** Nëse ata vazhdojnë ta injorojnë kuvenden e komunës së Rahovcit, ndërkohë ata paguhen njëjtë si ju. Është edhe përfaquesuesi i OSBE-së këtu dhe është mirë t'i tregoni atyre që ky shtet nuk ka para t'ju jep "badihava" njëzve që nuk e di a bëjnë ndonjë gjë apo jo, por edhe nëse nuk kanë arritur të bëjnë diçka, është mirë që të vijnë këtu në kuvend dhe të na raportojnë. Sa për informatë, 3 përfaqësues janë të komunitetit serb dhe 2 janë shqiptarë. Përndryshe, nëse nuk paraqitet do të flas me drejtorin e financave dhe mund ta bëjë një shkresë që nuk është mirë të paguhen, përderisa nuk po bëjnë asgjë.

### **11. Shqyrtimi i informatës për gjendjen e mbeturinave në komunën e Rahovcit, për 6-mujorin e parë të vitit 2025:**

**Albnor Mullabazi:** Para jush e keni informatën për gjendjen e mbeturinave në komunën e Rahovcit, në mungesë të drejtorit të Shërbimeve Publike do ta prezentoj unë. Në këtë raport janë të prezantuara aktivitetet financiare, operative dhe administrative. Është paraqitur inkasimi i mjeteve në vlerë prej 584.246€ nga Ekoregjioni, nga grumbullimi i mbeturinave në qytet dhe 13 fshatra. Për t'i shërbyer këtyre kategorive është angazhuar edhe "Ekodrinia", e cila i ka 3204 ekonomi familjare, 86 biznese dhe 25 institucione. Inkasimi nga Ekodrinia për periudhën e raportimit janar - qershor është 152.584€. Gjatë kësaj periudhe janë larguar edhe 6 deponi ilegale. Në raport janë të ilustruara edhe me foto aktivitetet që janë bërë.

**Ilir Pallqa:** Problemi në tërësi me mbeturina nuk është trajtuar. Bërrillog ka shumë, por tani ndoshta nuk po shihet, sepse është rritur bari. Nuk keni bërë ju ndonjë gjë. Natyra e ka rritur barin dhe e ka mbuluar marren e ekzekutivit në këtë drejtim. Në rrugë kryesore nuk ka shporta. Nëse e sheh ndonjë mbeturinë në rrugë, nuk mund ta largosh, sepse të bie ta mbash në dorë gjatë dhe njerëzit e kanë mërsi këtë gjë. Duhet të ketë shporta më shpesh, këtë gjë e kemi folur disa herë. Ju lutem të keni vëmendje, nëse mendoni që edhe mandatin tjetër ta mbani, duhet ta keni prioritet këtë gjë, sepse nuk i ka hije Rahovcit tonë të bukur t'i ketë rrugët fushore plot me mbeturina ilegale.

**Kryesuesi:** Faleminderit Ilir Pallqa! Të nderuar anëtarë të kuvendit, nëse nuk keni diçka tjetër, kemi ardhur në fund të mbledhjes. Ju falënderoj për vëmendjen dhe shihemi në seancën e radhës.

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

